

Raportim dhe rezultate nga Fokus Grupet

Gjatë muajit Dhjetor 2016, janë zhvilluar 10 fokus grupe në Ballsh dhe në njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër (Qëndër, Aranitas, Greshicë, Kutë, Selitë, Ngracan, Fratar, Hekal).

Nëpërmjet fokus grupeve u bë e mundur nxjerrja e problematikave të zonës dhe analiza e situatës ku gjenden të rinjtë. Vlerësimi i nevojave të komunitetit do të paraqitet si draft Bashkisë Mallakastër për ta marrë parasysh në investimet për vitin pasardhës duke renditur prioritetet dhe analizuar mundësitë.

Në fokus grupe morën pjesë të rinj të grupmoshës 17-30 vjec, 112 pjesëmarrës në total, përkatësisht 48 vajza dhe 64 djem. Pjesëmarrësit ishin nxënës shkolle, studentë, të rinj të papunë, të rinj të forumeve rinore politike, të rinj nga komuniteti rom, etj.

Përkatësisht ndarja e fokus grupeve:

- 5.12.2016 – Fokus grup me të rinj përfaqësues të grupeve vulnerabël Ballsh (2 vajza dhe 8 djem)
- 5.12.2016 – Fokus grup me të rinj të forumeve politike (2 vajza dhe 8 djem)
- 8.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Qendër (3 vajza dhe 7 djem)
- 8.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Aranitas (10 vajza dhe 2 djem)
- 10.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Greshice (8 vajza dhe 3 djem)
- 10.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Kute (8 vajza dhe 7 djem)
- 13.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Selite (7 djem dhe 4 vajza)
- 15.12.2016 – Fokus grup Njesia Administrative Ngracan (4 vajza dhe 4 djem)
- 21.12.2016 - Fokus grup Njesia Administrative Fratar (13 djem dhe 2 vajza)
- 21.12.2016 - Fokus grup Njesia Administrative Hekal (5 vajza dhe 5 djem)

Gjatë fokus grupeve u diskutuan probleme të ndryshme të iniciuara nga rezultatet e pyetësorëve, lidhur me njohuritë që të rinjtë kanë mbi funksionin e qeverisë lokale, angazhimin dhe të drejtën për t'u angazhuar të të rinjve, por edhe problematika të tjera konkrete.

Pyetjet orientuese lidhur me fokus grupet:

- Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat përballen të rinjtë e komunitetit tuaj?
- Sa aktive është rinia në komunitetin tuaj?
- A keni marrë pjesë në aktivitete që organizon njësia juaj administrative?
- A jeni drejtuar ndonjëherë tek organet e qeverisjes vendore për problematikat tuaja? (kur, si)
- A ka nevojë qeveria lokale për këshillim dhe nitje nga komuniteti për më shumë vëmendje tek rinia?
- Kush mendoni se duhet ta luajë këtë rol këshillues?
- Mendoni se një grup rinor i organizuar mund të përfaqësojë dhe llojë për problematikat e të rinjve te qeveria lokale?

- Cilat janë disa zgjidhje të mundshme të problemeve të evidentuara?

Problematikat dhe rekomandimet e dala nga focus grupet:

1- Demokracia dhe Vendimarrja

Të rinjtë janë një nga grupet sociale që megjithëse mbartin peshën e ndërtimit të së ardhmes së vendit, nuk e kanë të lehtë të përfshihen, të kërkojnë të drejtat e tëra apo të bëhen pjesë e vendim-marrjes/ politikëbërjes. Perceptimet rreth pengesave konkrete të të rinjve për t'u përzgjedhur, lidhen shpesh drejtpërdrejtë me faktin që të rinjtë duke qenë se janë në formim e sipër, nuk mund të marrin përsipër pozicione të rëndësishme në vendim-marrje e politikëbërje.

Tek të rinjtë pjesëmarrës në fokus grupe, interesimi në politikën e vendit është i konsiderueshëm. Por, pavarësisht interesit të konsiderueshëm në politikën shtetërore, të rinjtë besojnë se interesi i tyre ka ardhur duke u zbehur vitet e fundit. Ndaj politikës është përhapur një qëndrim i llojit "të gjithë janë njësoj", duke shkakuar kështu skepticizëm më të madh ndaj procesit politik.

Rekomandimet:

- Krijimi i grupit joformal të përbërë nga të rinj, grup i cili do të luante rolin e grupit avokues/lobues për çështjet e të rinjve. Kësisoj, të rinjtë do të kishin një vend për çështjet me interes të tyre, e cila do të shërbente edhe si urë lidhëse mes të rinjve dhe Bashkisë.
- Përmirësimi i cilësisë së komunikimit, duke funksionalizuar mediumet me të përdorura nga të rinjtë (p.sh hapja e faqes të Facebook-ut dhe Tëitter-it) ku të rinjtë do të mund të informoheshin dhe komunikonin me zyrtarët bashkiak.
- Rritja e ofrimit të shërbimeve rinore. Pra, ofrimi i hapësirave edukative dhe rekreative, funksionalizimi i qendrave dhe këshillave rinore, ndërtimi i infrastrukturës adekuate për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Ndrëshimi i qasjes së partive politike ndaj të rinjve. Kjo mund të bëhet përmes fuqizimit të strukturave rinore, p.sh dhënia e përgjegjësisë për zhvillimin e politikave për rininë tek strukturat rinore përkatëse.

- Në përgjithësi të rinjtë shprehin besim të ulët tek institucionet. Të rinjtë në fokus grupe, kanë shprehur me shumë mosbesim sesa besim ndaj institucioneve.

Rekomandimet:

- Rritje të transparencës.
- Llogaridhënie me të madhe.
- Rritje të cilësisë të komunikimit.
- Paanshmëri

- Të rinjtë sipas hulumtimit shumë pak marrin pjesë në nisma qytetare dhe pjesëmarrje në politikë. Do të thotë shfaqin një angazhim të ulët në politikë.

Rekomandimet:

- Të thyhen muret mes partive politike dhe rinisë përmes komunikimeve direkte/kontakteve të drejtpërdrejta apo indirekte përmes komunikimeve virtuale.
- Partitë politike duhet të jenë me të hapura ndaj të rinjve, ideve dhe iniciativave të tyre me qëllim që të tërhiqen më shumë të rinj për anëtarësime në parti politike.
- Promovimi i punës vullnetare dhe nismave qytetare përmes figurave publike që pëlqehen nga të rinjtë.

2- Papunësia dhe varfëria

Pjesëmarrësit në fokus grupe, janë të shqetësuar për "Papunësinë" dhe "Rritjen e varfërisë", si dy problemet më të theksuara në shoqëri. Respektivisht, 94% dhe 92% e tyre besojnë se këto dy çështje janë shumë shqetësuese. Kjo pasi nuk ka vende pune në zonën e tyre, uzinat dhe bizneset përreth punësojnë njerëz nga qytetet e tjera dhe nuk favorizojnë fuqinë vendase punëtore.

Rekomandimet:

- Informimi i qytetareve për proceset kyçe në politikë.
- Prioritizimi i zhvillimit ekonomik me fokus të punësimit të të rinjve.
- Kanalizimi i optimizmit në iniciativa zhvillimore.
- Hapja e bizneseve sociale

3- Arsimi dhe Punësimi

Pjesa dërmuese e të rinjve në Bashkinë Mallakastër sipas rezultateve të fokus grupeve dëshirojnë të vazhdojnë arsimin universitar. 92% e të rinjve deklarojnë se kanë ndërmend të ndjekin universitetin pasi të përfundojnë shkollën e mesme:

Rekomandimet:

- Stimulimi i bizneseve, në mënyrë që të krijohet një bindje se edhe të vazhdosh një biznes të caktuar mund të jetë përfitues për të ardhmen e një të riu.
- Rritja e kriterëve në mundësinë e pranimit në Universitet.
- Hapja e shkollave profesionale, në mënyrë që nxënësit nga ato shkolla të dalin të përgatitur për tregun e punës.

- Një shqetësim tjetër i dalë nga diskutimet në fokus grupe, është se të rinjve po qe se do u jepej mundësia, pjesa më e madhe e tyre do të preferonte të studionte apo emigronte jashtë shtetit. Rreth 61% e të rinjve deklarojnë se duan të studiojnë në një shkollë jashtë shtetit, nëse do u jepej mundësia.

Pritshmëritë e tyre të punësimit pas diplomimit janë shumë të ulëta. Më shumë se një e treta e atyre të cilët janë të punësuar nuk punojnë në profesionin për të cilët janë arsimuar.

Rekomandimet:

- Hapja apo pranimi i numrit të studenteve në drejtimet universitare në proporcion me nevojat e tregut. Duke i stimuluar ato degë të studimeve, për të cilat ka nevojë tregu. Pra, që të krijohet një ekuilibër mes mundësive që ka tregu i punës dhe numrit të studentëve të cilëve u jepet e drejta e studimit.
- Krijimi i një partneriteti publiko-privat, mes Universitetit dhe bizneseve të ndryshme, duke ju mundësuar studenteve kryerjen e një praktike 3 mujore, dhe kështu të krijojnë një bazë të qëndrueshme praktike për të ardhmen e tërë në karrierë.
- Arsimi profesional ka nevojë për një reformë përmbytëse, në mënyrë që të sapo diplomuarit të jenë me shkathtësi praktike dhe konkurrense në tregun e brendshëm, rajonal apo dhe atë evropian.

- Sipas rezultateve të fokus grupeve, niveli i punësimit në Bashkinë Mallakastër tek të rinjtë është shumë i vogël. Rezulton se , më pak se një e katërta (18%) deklaruan se janë të punësuar në një pozicion me kohë të plotë apo të pjesshme.

Rekomandimet:

- Ndryshimi i prioriteteve të politikave qeveritare. Investimi në arsim është investim në të ardhmen dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në ekonomi.
- Fuqizimi i qendrave për aftësim profesional që është përgjegjësi e Ministrisë Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- Ngritja e kapaciteteve të shkollave profesionale. Me fjalë të tjera, shkollat profesionale duhet të funksionojnë si ndërmarrje të vogla ekonomike, të cilat duhen të jenë shtylla kryesore zhvillimore të ndërmarrjeve të ardhshme, prodhuese dhe shërbyese.

- Administrata publike është sektori i preferuar i punësimit ndër të rinjtë, pavarësisht gjinisë, vendbanimit apo etnisë.

Rekomandimet:

- Nxitja e aktiviteteve të tjera, nëpër sektorë të tjerë duke i bërë ato me tërheqëse për të rinjtë.
- Është krijuar një perceptim kolektiv se në administratë edhe nëse nuk punon “rroga do të hidhet”. Prandaj është e rëndësishme një mbikëqyrje dhe monitorim nga grupe të jashtëm, për të thyer këtë stereotip.
- Vizita dhe përfshirja e grupeve në takime dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga qeverisja vendore.

- “Njohjet dhe miqtë” janë faktorët më të rëndësishëm për të gjetur një punë, sipas mendimit të të rinjve të Bashkisë Mallakastër. Këta faktorë kanë më shumë peshë sesa “aftësia profesionale” apo “niveli i arsimimit”. Rreth 70% e të rinjve pjesëmarrës në fokus grup besojnë se faktori më i rëndësishëm për të gjetur punë janë “njohjet dhe miqtë”. Nëse përfshihen edhe “lidhjet politike”, atëherë rreth 60% e të rinjve përmendin këta faktorë si më të rëndësishmit për gjetur punë.

Rekomandimet:

- Forcimi në praktikë i parimit “barazi në mundësi”. Do të thotë promovimi i një shoqërie në të cilën çdonjëri ka të drejtë të konkurroj për vende të punës, dhe në fund të pranohen vetëm individët me kualitetet më të duhura profesionale.
- Ndryshimi i qasjes së punësimit në baza partiake, depolitizim i plotë në punësim.
- Forcimi në zbatueshmëri të ligjit për “konflikt interesi”. Komisioni duhet të jetë apolitik, i pavarur dhe jo me lidhje farefisnore.
- Llogaridhënie dhe transparencë me të madhe në institucionet e vendit. Krijimi i një politike për qasje më lehtë në informacion, që kështu rastet në të cilat dikujt pa të drejtë i është mohuar e drejta për punësim të mund të evidentohet.

4- Mënyra e jetesës dhe koha e lirë

- Mungesa e aktiviteteve artistike, kulturore dhe sportive. Vetëm 25% e të rinjve të pyetur praktikojnë shpesh sport, 5 % marrin pjesë në aktivitete kulturore që organizon shkolla e mesme në qytetin e Ballshit.

Rekomandimet:

- Organizimi i aktiviteteve rekreative, artistike dhe kulturore nga drejtoritë përgjegjëse pranë pushtetit local.
- Promovimi i aktivitetit fizik dhe edukatës fizike përmes klubeve sportive shkollore.
- Organizimi i garave sportive mes shkollave.
- Bursa për nxënësit e talentuar në art, sportistët e dalluar, p.sh regjistrimi në fakultet pa provim pranues.
- Të angazhohen shkollat për promovimin dhe nxitjen e aktiviteteve artistike, kulturore dhe sportive.
- Bashkia të krijoj hapësira për aktivitete rinore.

5- Infrastruktura

Një nga problemet më të mëdha të të rinjve në zonat rurale lidhet me infrastrukturën rrugore e cila në pjesën më të madhe të saj është shumë e dëmtuar. Si rezultat kjo pengonte në marrjen më të shpejtë të shërbimeve. Mungojnë kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza, ndricimi në rrugë.

Rekomandimet:

- Hartimi i një plani ndërhyrjeje për investim nga qeveria locale për marrjen e masave.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit. Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit.
- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit. Asnjë nga fshatrat nuk janë të lidhur me rrjetin e ujësjellësit.
- Të sigurohet transporti për nxënësit
- Të vendoset ndriçimi publik në të gjitha fshatrat.

6- Shërbimet Sociale

Mungesa e theksuar e shërbime sociale. Nuk ofrohet shërbim për grupet në nevojë. Nuk ka organizata që të veprojnë dhe të mbrojnë interesat e grupeve në nevoje. Nuk funksionojnë sindikatat.

Rekomandime:

- Shërbime të orientuara për grupet në nevojë
- Hartimi i një plani social.